

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023
Ora 14:12**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për disa këshilla bashkiak dhe dhënien e mandateve për disa kryetarë bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në sencën e sotme publike kemi në rend dite çështjet që lidhen me shpërndarjen e mandateve për anëtar të këshillit të bashkisë për disa bashki dhe për dhënie mandati të kryetarit të bashkisë për disa bashki. Atëherë fjala për ju zoti Sekretar.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” e Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një KZAZ. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor të bashkive Rrogozhinë, Belsh, Kuçovë, Shkodër, Lushnje, Fier dhe Berat kanë miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit dhe vendimit të Komisionerit

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

Shtetëror të Zgjedhjeve dhe kundër këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë ankim brenda afatit ligjor. Rezultati për subjektet zgjedhore, renditja e subjekteve dhe shpërndarja e mandateve është bërë në bazë të nenit 162, pika 1, 2 dhe 4 e kodit Zgjedhor. Gjithashtu bashkëlidhur këtyre projektvendimeve janë dhe tabelat ku janë renditur subjektet zgjedhore sipas numrit të votave të marra. Sipas nenit 163, pika 1 dhe nenit 166, pika 3 të Kodit Zgjedhor menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit. Për sa më sipër, KQZ-ja përllëgarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për ç'do subjekt, në bazë të renditjes të listave shumemërore të subjekteve zgjedhore. Nisur nga tabela e rezultateve i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore për zonat zgjedhore bashkitë Rrogzhinë, Belsh, Kuçovë, Shkodër, Lushnje, Fier dhe Berat. Gjithashtu për dhënien e mandatit për kryetarët e bashkive referuar nenit 33, shkronja “g” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor shpall fitues kandidatin, i cili ka marrë numrin më të madh të votave, në zgjedhjet që kanë votuar në njësitë vendore përkatëse. KZAZ-të përkatëse kanë marrë vendim sipas tabelave të miratuara nga këto KZAZ për kryetarët e bashkive Pukë, Tropojë, Kurbin, Dibër, Mallakastër, Përmet, Memaliaj, Gjirokastrë, Shkodër, Lushnje, Fier dhe Berat. Bazuar te këto tabela të miratuara nga KZAZ-të i propozojmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhënien e mandatit për kryetarët e bashkive Pukë, Tropojë, Kurbin, Dibër, Mallakastër, Përmet, Memaliaj, Gjirokastrë, Shkodër, Lushnje, Fier dhe Berat. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë miratojmë dhënien e mandatit të kryetarit të Kryetarit të Bashkisë Pukë, zotit Rrok Dodaj, propozuar nga subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, zotit Rexhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

Byberi, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, zonjës Majlinda Cara, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Dibër, zotit Rahim Spahiu, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, zotit Qerim Ismailaj, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Përmet, zonjës Alma Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, zotit Albert Malaj, propozuar nga subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, zotit Flamur Golemi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, zotit Benet Beci, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Këto janë të rendit të ditës, më pas kemi dhe të shtuarat, dhënien e mandatit të kryetarit të Kryetarit të Bashkisë Lushnje Eriselda Sefa, mbështetur nga subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Fier, zotit Armando Subashi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Berat, zotit Ervin Demo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në lidhje me shpërndarjen e mandateve për këshillat e bashkisë për Bashkinë Lushnje shpërndarja e vendeve për këshillin bashkiak është si më poshtë:

- Bashkë Fitojmë 7 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 24 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 1 mandat.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 2 mandate.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

- Partia Demokratike 4 mandate.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Fier është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 7 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 33 mandate.
- Aleanca Liberale e Djathtë 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 5 mandate.
- Partia Demokratike 4 mandate.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Berat është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 7 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 20 mandate.
- Partia Demokratike 3 mandate.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Shkodër është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 13 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 18 mandate.
- Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat.
- Aleanca Liberale e Djathtë 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 12 mandate.
- Partia Demokratike 5 mandate.
- Fryma e Re Demokratike 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Rrogozhinë është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 4 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 9 mandate.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.

*Zbardhi materialin audio
Artinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

- Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 2 mandate.
- Partia Demokratike 3 mandate.
- Mitat Kadri Daja 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Belsh është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 2 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 10 mandate.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Partia Lëvizja e Legalitetit 2 mandate.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.
- Partia Demokratike 3 mandate.
- Aleanca Progresiste L.ZH.K 1 mandat.
- Partia e Gjellbër 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Kuçovë është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 8 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 18 mandate.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.
- Partia Demokratike 3 mandate.
- Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë 1 mandat.

Vendimet nr. 622 – 634 dhe 637 - 642

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

**26.05.2023
Ora 14:21**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për korrigjim material në vendimin nr. 539, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin Bashkiak, zona zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kemi edhe 2 korigjime vendimi.

Z. Y. Merkaj: Falemiderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancën publike dt. 20 maj 2023 ka marrë në shqyrtim çështjen me objekt miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kryetar bashkie dhe Këshillin e Bashkisë Elbasan për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri me vendimin 539, dt. 20.05.2023 ka vendosur miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kryetar bashkie dhe tabelën e kryetarëve për Këshillin e Bashkisë Elbasan, të KZAZ-së nr. 47 Bashkia Elbasan. Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë sipas lidhjes 1 që i

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

bashkëlidhet këtij vendimi. Shpalljen e kandidatit të propozuar nga Partia Socialiste si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për Këshillin e Bashkisë Elbasan. KQZ-ja ka konstatuar një gabim në pasqyrimin e të dhënave në tabelat përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së nr. 47 dhe KZAZ-nr 50. Konkretisht për KZAZ-në 47 dhe KZAZ-në 50 është konstatuar një gabim në QV-në 2477 të KZAZ-së nr. 47, QV-në 2416/00 të KZAZ-së nr. 47, QV-në nr. 2477/00 të KZAZ-së nr. 47, QV-në 2350/00 të KZAZ-së nr. 50. Në bazë të nenit 112 të Kodit të Procedurave administrative, përcaktuese e organit publik në çdo kohë, kryesisht një kërkesë mund t'i korigjojë gabimet me shkrim, gabimet në përlllogaritje ose ky saktësim të jetë i dukshëm në një akt administrativ. Për saktësimin e këtyre rezultateve të mësipërme konstatohet se nuk ka asnjë ndryshim në ndarjen e mandateve. Për këtë arsye i propozojmë Komisionerit korigjimin e materialit me vendimin nr. 539 dt. 20.05.2023 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë dhe për këshillin e bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Elbasan sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mitë atëherë, bëjmë korigjimin material të gabimit të tabelave përkatëse sipas lidhjeve që do i bashkëlidhen këtij vendimi.

Vendimi nr. 635

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

26.05.2023
Ora 14:24

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për korigjim material në vendimin nr. 536, datë 20.5.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin Bashkiak, zona zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me korigjimin tjetër.

Z. Y. Merkaj: Kemi dhe korigjimin e tabelës për Bashkinë Kamëz, e njëjta situatë është dhe kjo. Komisioneri ka miratuar tabelën përmbledhëse. KQZ-ja ka konstatuar se ka dy gabime dhe konkretisht në QV-në nr. 570/01 të KZAZ-së nr. 27 1570/01 të KZAZ-së nr. 27. Për këtë arsye i propozojmë Komisionerit korigjimin e gabimit sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.05.2023*

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë, bëjmë korigjimin e gabimit material edhe për këtë rast sipas tabelës që do i bashkëlidhet këtij vendimi. Çështje të tjera nuk kemi, faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 636

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*

